

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përpjekja e SHBA-së për uljen e çmimeve të ilaçeve mund të sjellë pritje më të gjata për pacientët europianë - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/perpjekja-e-shba-se-per-uljen-e-cmimeve-te-ilaceve-mund-te-sjelle-pritje-me-te-gjata-per-pacientet-europiane/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:27:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 07:26:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7dce76c8a14bd876c638872c65eb9ca76df4c905b249e7b5cb5e2527fbbcef8e
TEKSTI	88e3b508c4a5a465a80eb5249b59fb1de58808ed33436b4adc2a2b57fa0e44b6
PAMJA	f769342bd4315a3ed85473792bd51cfcb68cc269dcfce7717f44adadf9766b90

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	625c1c682e35a2e6842201f7df290b233b9b83e6a8fd234851fd2ae1260d7270
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ac1c8d986ca8a5982bfff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/625c1c682e35a2e6842201f7df290b233b9b83e6a8fd234851fd2ae1260d7270>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Donald Trump Viti i ri shkollor Inteligjenca Artificiale Alket Rizai

EVROPA

Përpyjekja e SHBA-së për uljen e çmimeve të ilaçeve mund të sjellë pritje më të gjata për pacientët europianë

LAJMI I FUNDIT

09:22 Kane shënon golin e 150-të për Bayernin në fitoren ndaj Elversbergut

09:15 "Zhdukjet" Alket Rizai, si ndodhi konflikti në plazhin grek ku u përfshi "magjistari i arratisjeve"

09:05 Vazhdon seanca në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, palët japin sot përgjigjet përfundimtare

09:04 Gjermania synon një fillim të ri SHPËRNDARJE me Hungarinë, ministri i ARTIKULLIN Jashtëm bën vizitën e parë që nga rrëzimi i Orbanit

08:53 Raporti: Himalajet po i afrohen një pike kritike, miliona jetë në rrezik

08:47 Zelenskyy u kërkon ligjvënësve të mbështesin shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm

14 Shtator 2026 | 09:26

Pacientët në Europë mund të përballen me pritje më të gjata për disa ilaçe të reja, pasi përpyekjet e SHBA-së për të ulur çmimet e barnave rrezikojnë të nxisin kompanitë farmaceutike të vonojnë hedhjen e tyre në tregjet me çmime më të ulëta, sipas një studimi të ri.

Në maj të vitit të kaluar, presidenti amerikan Donald Trump kërkoi që çmimet e ilaçeve në SHBA të përafroheshin me nivelet më të ulëta të vendeve të tjera të zhvilluara, në kuadër të të ashtuquajturit mekanizëm të çmimeve të "kombit më të favorizuar". Megjithatë, kjo politikë e çmimeve mund të ketë pasoja negative.

Pacientëve europianë mund t'u duhet të presin më gjatë për disa ilaçe të reja, ndërsa SHBA-ja u kërkon kompanive farmaceutike të ofrojnë çmime që përputhen me ato të vendeve të tjera me të ardhura të larta, si Gjermania ose Franca, sipas një studimi të ri modelues të publikuar në revistën The Lancet.

Studiuesit analizuan 195 ilaçe të patentuara, të cilat së bashku përbëjnë 87.9 miliardë dollarë të shpenzimeve vjetore të SHBA-së. Ata zbuluan se për tre në katër ilaçe të përfshira në studim, paratë që kompanitë do të humbnin nga ulja e çmimeve në SHBA do të ishin më të mëdha se të ardhurat e tyre totale vjetore në vendet që përdoren për përcaktimin e çmimeve në SHBA.

Për të minimizuar humbjet në SHBA, tregu më i madh farmaceutik në botë, kompanitë "mund të nxiten të vonojnë hedhjen në treg të ilaçeve në vendet me çmimet më të ulëta në tregun referues", thanë studiuesit. Duke vonuar hedhjen në treg, kompanitë farmaceutike mund të shmangin detyrimin për t'i përshtatur këto çmime më të ulëta edhe në SHBA.

"Politikat në SHBA mund të ndikojnë në aksesin ndaj ilaçeve në mbarë botën", tha autorja e studimit, Kerstin Vokinger, nga ETH Zurich dhe Universiteti i Zurichut, në një deklaratë për shtyp.

Ata që do ta ndienin përfundimisht ndikimin janë pacientët.

"Rreziku është shumë konkret: nëse kompanitë farmaceutike vonojnë hedhjen në treg të ilaçeve në Europë, sepse çmimet europiane mund të përdoren për përcaktimin e çmimeve

TESTIM

në Shtetet e Bashkuara, pacientët këtu mund të presin më gjatë për trajtime që janë tashmë të disponueshme diku tjetër”, tha European Patients Forum për Euronews Health në një koment me shkrim. “Për dikë që jeton me një sëmundje të rëndë ose progresive, një pritje shtesë mund të ketë ndikim real në shëndetin dhe cilësinë e jetës.”

Politika e SHBA-së ka tashmë ndikim në Europë

Europa ka parë një rënie të hedhjes në treg të ilaçeve të reja gjatë muajve të fundit. Dhjetë muaj pas urdhrit ekzekutiv të Trump, hedhja në treg e ilaçeve në tregjet e BE-së ra me rreth 35% krahasuar me 10 muajt e mëparshëm, raportoi Reuters në mars.

Ndërsa nuk është e qartë nëse rënia lidhet drejtpërdrejt me politikat e SHBA-së, në shkurt u njoftua se tërheqja nga tregu e një ilaçi për trajtimin e rasteve veçanërisht të rënda të kolesterolit të lartë mund të jetë shkaktuar nga politika e presidentit amerikan Donald Trump për çmimet e ilaçeve.

“Është e vërtetë se edhe në vende më të mëdha si Gjermania, ne shohim kompani që po rishqyrtojnë nëse duhet të hedhin një ilaç në treg apo kur duhet ta bëjnë këtë”, tha Alexander Natz, drejtues i lobit të sipërmarrësve të bioteknologjisë Eucope, për Euronews, duke shpjeguar se situata aktuale i detyron kompanitë farmaceutike të mendojnë dy herë përpara se të hedhin një ilaç në treg.

“Nuk duhet të presim që të mos kemi akses në asnjë ilaç, por duhet të presim që kompanitë t’i marrin vendimet në një mënyrë shumë më të kujdesshme”, shtoi ai.

Natz beson se, për të garantuar që Europa të ketë ilaçe të reja pa vonesa, qeveritë duhet të jenë të gatshme të shpenzojnë më shumë.

“Duhet të kemi një debat, një debat të brendshëm politik në Gjermani dhe në vende të tjera, për sa jemi të gatshëm të shpenzojmë për kujdesin shëndetësor?”, tha ai.

Vendet po e ndiejnë tashmë këtë presion mbi buxhetet e tyre të kufizuara.

“Vendet referuese, nga Gjermania te Japonia dhe Australia, po përballen me presion të konsiderueshëm nga administrata amerikane dhe industria për të rritur çmimet dhe shpenzimet për ilaçet”, tha Thomas Hwang nga Brigham and Women’s Hospital dhe autori kryesor i studimit.

“Por kjo përplaslet me realitetin se vendet e tjera kanë hapësirë të kufizuar buxhetore për të dhënë më shumë”, shtoi ai.

Për të minimizuar pasojat negative, autorët e studimit vërejnë se prodhuesit dhe vendet mund t’u drejtohen çmimeve të listuara pra çmimit të deklaruar nga prodhuesi përpara zbritjeve – në vend të çmimeve neto, të cilat pasqyrojnë zbritjet konfidenciale.

Ndërkohë, sipas rregullave të përditësuara së fundmi të Bashkimit Europian për ilaçet, një kompani duhet ta hedhë një ilaç të ri në treg nëse një vend e kërkon këtë brenda tre vitesh ose rrezikon të humbasë dy vite të të drejtave të monopolit.

Ky kusht shërben si një “kundërpeshë” ndaj pasojave të politikës së Trump për çmimet e ilaçeve. Megjithatë, autorët shkruan se ai “nuk ka gjasa të ndryshojë në mënyrë domethënëse madhësinë e kursimeve në vetvete”. Edhe Natz ishte skeptik nëse kjo masë mund të jetë e mjaftueshme për të eliminuar pasojat e mundshme negative të politikës amerikane të çmimeve.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA

Gjermania synon një fillim të ri me Hungarinë, ministri i jashtëm bën vizitën e parë që nga rrëzimi i Orbanit

Ministri i Jashtëm gjerman, Johann Wadephul e përshkroi udhëtimin e tij në Budapest të hënën – i pari i një ministri të jashtëm gjerman në...

09:04 | 14/09/2026

BOTA | EVROPA

Zelenskyy u kërkon ligjvënësve të mbështesin shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy tha të hënën se po u kërkonte ligjvënësve të mbështesin shkarkimin e prokurorit të përgjithshëm të Ukrainës pa vonesë. Prokurori...

08:47 | 14/09/2026

BOTA | EVROPA

Aksident i rëndë në Turqi, autobusi përfshihet nga flakët pas rënies së 3 viktimave dhe 8 të

nga maket pas përplasjes, 2 viktima dhe 6 të plagosur (VIDEO)

Një aksident i rëndë është regjistruar në autostradën Veriore Marmara në Turqi ku një autobus që u përplas me barrierat e pagesës dhe më pas shpërtheu në flakë. Fatkeqësisht...

08:19 | 14/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.